



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr.03/ L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 29 janar 2018, miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.01/2018 PËR CAKTIMIN E NORMËS
ORIENTUESE PËR PROKURORËT E SHTETIT**

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet norma orientuese vjetore për kryerjen e lëndëve për prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm, të Departamentit për të Mitur dhe Departamentit për Krime të Rënda të të gjitha Prokurorive Themelore, Departamentit të Përgjithshëm dhe Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Norma vjetore

1. Norma orientuese vjetore për kryerjen e kallëzimeve -lëndëve penale përcaktohet si në vijim:
 - 1.1 Prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorive Themelore janë të obliguar që të kryejnë së paku **23** kallëzime-lëndë penale në muaj, përkatësisht **253** kallëzime - lëndë penale të kryerësve madhor të veprave penale gjatë një viti.¹
 - 1.2 Prokurorët e Departamentit për të Mitur të Prokurorive Themelore janë të obliguar që të kryejnë së paku **10** kallëzime- lëndë penale në muaj, përkatësisht **110** kallëzime-lëndë penale të kryerësve të mitur të veprave penale gjatë një viti.

¹ Viti kalendarik për punën e një prokurori zgjat 11 muaj, ndërsa një muaj i pushimit vjetor nuk llogaritet si periudhë pune.

- 1.3 Prokurorët e Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore janë të obliguar që të kryejnë së paku **6** kallëzime-lëndë penale në muaj, përkatësisht **66** kallëzime-lëndë penale të kryesve madhor të veprave penale gjatë një viti.
- 1.4 Prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Apelit, janë të obliguar që të kryejnë së paku **50** lëndë penale në procedurën e shkallës së dytë në muaj, lëndë penale të ankesave me paraburgim dhe lëndë të ndryshme, përkatësisht **550** lëndë në vit (Regjisti PPA/II, PAR/II dhe PPN/II).
- 1.5 Prokurorët e Departamentit të Krimeve të Rënda të Prokurorisë së Apelit, janë të obliguar që të kryejnë së paku **30** lëndë penale të procedurës së shkallës së dytë në muaj, lëndë penale të ankesave me paraburgim për kryerësit madhor e të mitur dhe lëndë të ndryshme penale, përkatësisht **330** lëndë në vit, (Regjistri PPA/I, PAR/I, PAR/M dhe PAR/I).
- 1.6 Prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës janë të obliguar që të kryejnë së paku **2** kallëzime-lëndë penale në muaj, përkatësisht **22** kallëzime-lëndë penale në vit.

Neni 3

Kriteret themelore për llogaritjen e lëndëve penale

- 1 Kallëzimet penale të kryerësve të panjohur të veprave penale nga regjistri "PPP", llogariten si normë në raport 20:1 me lëndët nga regjistri "PP", nëse është bërë së paku 1 kërkesë për kallëzim penal.
- 2 Lëndët e ndryshme penale nga regjistri "PPN", llogariten si normë në raport 8:1 me lëndët nga regjistri "PP".
- 3 Lëndët për ndihmë juridike ndërkombëtare nga regjistri "NJN" llogariten si normë në raport 6:1 me lëndët nga regjistri "PP", nëse dorzohet në Ministrinë e Drejtësisë si lëndë e kryer.

Neni 4

Përmbushja e normës

Vlerësimi për përmbushjen e normës do të bazohet mbi të dhënat e pranuar nga aplikacioni i Bazës së të dhënave të instaluar nëpër çdo prokurori, raporteve statistikore të prokurorëve dhe në bazë të vlerësimit të ndërlikueshmërisë së kallëzimit-lëndës penale nga Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse.

Neni 5

Mënyra e zgjedhjes së kallëzimeve- lëndëve penale

1. Lënda nga regjistri "PP", konsiderohet e kryer me hudhjen e kallëzimit penal, pushimin e hetimit apo ngritjen e aktit akuzues.
2. Lënda nga regjistri "PPM", konsiderohet e kryer me hudhjen të kallëzimit penal, pushim të procedurës penale, shqiptim të masës së diversitetit, propozimit për shqiptimin e masës edukative ose dënimit.
3. Lënda apo regjistri "PPN", konsiderohet e kryer, me përpilimin e raportit për mbylljen e rastit apo për mos fillim të ndonjë procedure. Kur lënda kalohet në regjistrat "PP" ose "PPM", llogaritet si lëndë e kryer, mirëpo nuk llogaritet si normë në regjistrin "PPN", por kalon si normë në regjistrin "PP".
4. Lënda nga regjistri "PPP", konsiderohet e kryer kur kallëzimi penal hudhet. Gjithashtu lënda konsiderohet e kryer kur kryerësi i veprës penale zbulohet dhe lënda kalohet në regjistrin "PP" ose "PPM", mirëpo nuk llogaritet si normë në regjistrin "PPP", por kalon si normë në regjistrin "PP" ose "PPM".
5. Lënda e pezulluar me aktvendim nuk konsiderohet e kryer, por për këtë veprim raportohet.
6. Lënda e dërguar në kompetencë lëndore llogaritet si normë nëse para dërgimit në kompetencë janë ndërmarrë 10 veprime procedurale, ndërsa nuk llogaritet normë nëse dërgohet për shkak të kompetencës territoriale.

Neni 6 Ndërlikushmëria e lëndës

1. Vendimin se një lëndë nga regjistri "PP" dhe "PPM" është e ndërlikuar e merr Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme.
2. Lëndët me 4 e më shumë vepra penale llogariten si dy (2) lëndë.
3. Lëndët që konsiderohen si çështje të ndërlikuara në kuptim të nenit 19 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Kodit të Procedurës Penale, llogariten si dy (2) lëndë.
4. Nëse lënda nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni kryhet me hudhjen e kallëzimit penal llogaritet si një lëndë.
5. Rast i ndërlikuar i korrupsionit sipas paragrafit 3 të këtij neni nënkupton rastet kur përfitimi ose demi është mbi 1,000.00€, si dhe korrupsioni i nivelit të lartë pavarësisht vlerës.
6. "Shumë prova mjekoligjore apo analiza kontabiliteti", sipas këtij neni nënkupton më shumë se 3 ekspertiza vendore apo 1 ekspertizë ndërkombëtare.

Neni 7

Lënda shumë e ndërlikuar dhe shumë e veçantë

1. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse në pajtim me Kryeprokurorin e Shtetit, përjashtimisht mund të vlerësojë se një lëndë është shumë e ndërlikuar dhe e rëndësisë së veçantë dhe llogaritet 5 lëndë nëse janë plotësuar njëri nga kriteret e nenit 6 të këtij udhëzimi dhe nëse plotësohen kriteret e veçanta si në vijim:
 - a. Nëse janë më tepër se 20 persona të përfishirë në kryerjen e veprës penale;
 - b. Nëse janë më tepër se 20 persona të dëmtuar me vepër penale apo më tepër se 30 dëshmitarë;
 - c. Nëse bëhet fjalë për krim të organizuar me element ndërkombëtar;
 - d. Nëse bëhet fjalë për terrorizëm me element ndërkombëtar;
 - e. Nëse bëhet fjalë për vrasje nga neni 126 te Kodit Penal dhe vrasjet tjera me potencial për destabilizim të gjendjes së sigurisë dhe rendit kushtetues;
 - f. Nëse bëhet fjalë për krimet e luftës.
2. Lëndët nga paragrafi 1 i këtij neni kur kryhen me hudhjen e kallëzimit penal dhe pushimi llogariten si një lëndë.

Neni 8

Zbatimi i Udhëzimit

1. Njësitë për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve obligohet që t'i ofrojë Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të dhënat për normën e prokurorëve sipas këtij udhëzimi.
2. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve është i obliguar që të bëjë vlerësimin e normës së prokurorëve bazuar edhe në këtë udhëzim.
3. Kryeprokurori i Shtetit mund të nxjerrë Vendime për zbatimin dhe mbikëqyrjen e aplikimit të këtij Udhëzimi nga Prokurorët.

Neni 9

Përjashtimi i zbatimit të Udhëzimit

1. Ky Udhëzim nuk zbatohet për rastet si në vijim:
 - 1.1.Për prokurorët që ndjekin trajnimet fillestare në Akademinë e Drejtësisë;
 - 1.2.Për prokurorët që me vendim të Këshillit lejohen për të ndjekur studimet apo specializimet e caktuara-veçanta;
 - 1.3.Për kohën kur prokurorët mungojnë nga puna për shkaqe shëndetësore;

- 1.4.Për kohën kur prokurorët janë në pushim të lehonisë;
- 1.5.Për raste tjera kur e kërkon ligji ose me vendim të Këshillit;
- 1.6.Për rastet kur Kryeprokurori i Shtetit e cakton një prokuror apo grup të prokurorëve për hetimin e një rasti të rëndësisë së vecantë.

Neni 10 **Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit**

1. Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Udhëzimi bëhet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë me të cilën është nxjerrë.
2. Ky Udhëzim shfuqizon udhëzimet dhe rregulloret tjera që kanë pasur për qëllim caktimin e normave orientuese vjetore për prokurorët e shtetit.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe do të aplikohet për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe prokurorive për lëndët e zgjedhura nga data 01 prill 2018.

Prishtinë më, 29 janar 2018



Blerim Isufaj

Kryesues

Këshilli Prokurorial i Kosovës